

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>          Republika Kosova – Republic of Kosovo          Qeveria – Vlada – Government</p> <p style="text-align: center;">Ministria e Punëve të Brendshme    Ministarstvo Unutrašnjih Poslova          Ministry of Internal Affairs</p> <p style="text-align: center;">Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/          Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate</p>	
---	---	---


## MANUALI I TESTIMIT

**Udhëzues për zhvillimin e testimit me shkrim në mënyrë  
elektronike përmes sistemit informativ.**


PROCEDURA E TESTIMIT ME SHKRIM PËR ZYRTARË POLICOR PËRMES SISTEMIT “ONLINE”

*Mos filloni testimin pa i pranuar të gjitha udhëzimet e nevojshme nga Anëtarët e caktuar të panelit të testit me shkrim.*

1. Sigurohu që në desktop të kompjuterit është ikona **Qendra e testimit** si ne foto




2. Klikoni mbi ikonën me emrin Qendra e testimit për te hapur qendrën e testimit si ne foto1.



[Foto. 1] Desktopi i kompjuterit

3. Pasi te keni kaluar hapin 2 dhe keni hapur qendrën e testimit [foto 2], tek **përdoruesi** shkruani numrin tuaj te aplikimit qe keni pranuar përmes emailit nga eKosova apo nga komisioni përzgjedhës, ndërsa tek fjalëkalimi e shkruani numrin tuaj personal (Kujdes të gjithë duhet të kyçeni me opsionin Domain)



Qendra e testimit


Përdoruesi:

Fjalëkalimi:

Lokal  Domain


[Foto. 2] Qendra e testimit elektronik

4. Pasi te klikoni butonin **kyqu**, ne sistem do te hapet dritarja si ne [foto 3] ku duhet te klikoni butonin **FILLO TESTIN**




[Foto. 3] Testi i ndare automatikisht nga sistemi

5. Pasi te keni kaluar hapin 4 do te hapet një dritare tjetër qe tregon kohën nëse testi ka filluar apo pritët te filloj për disa minuta [foto 4]




[Foto. 4] Faqja për informatat e testit

6. Pasi te bëhen te gjitha minutat zero ne numëruesin e kohës atëherë do te shfaqet butoni **Fillo testin** ku ju duhet te klikoni ne këtë buton ne mënyrë qe te hapet testi [Foto 5].



[Foto. 5] Faqja për informatat e testit


7. Pasi te keni kaluar hapin 6, sistemi ne mënyrë te rastësishme do të paraqet testin me pyetje dhe opsionet për ju. Ju lutem lexoni pyetjet me kujdes dhe klikoni vetëm një të një nga përgjigjet opsionale poshtë secilës pyetje [foto 6].



[Foto. 6] Paraqitja e testit me shkrim

**Vëmendje:** Mos klikoni butonin **Dërgo testin** (i cili gjendet ne fund te testit) pa qenë i sigurt se nuk doni të ndryshoni më asgjë në përgjigjëjet e dhëna në test sepse nuk mund të ktheheni më në test. Deri në momentin kur klikoni në këtë buton ju mund të ndryshoni përgjigjet që keni dhënë. Gjithashtu, kujdesu që te përgjigjesh ne kohen e përcaktuar për testim pasi që nëse nuk e dërgoni testin ne kohen e përcaktuar, sistemi do e beje këtë për ju ne mënyrë automatike dhe do ju mbyllet faqja e testit.

8. Pasi te keni klikuar butonin **Dërgo testin** në monitor do të ju shfaqet rezultati me numrin e pikëve te arritura [foto 7].



Pyetje	Pikë
1. Arbeni ka në çantë 6 lapsa me ngjyra të ndryshme. Ai merr pa parë ngjyrat, vetëm dy lapsa. Sa kombinime të ndryshme të ngjyrave mund të ketë në dy lapsat e marrë nga Arbeni?	0.00 pikë
2. Cilat ngjarje historike janë radhitur drejt sipas rendit kronologjik?	0.00 pikë
3. Nina e ditëgjoi Litinë në dyqan për të marrë 9 kuti konservash me bizele. Liria mund të mbante vetëm dy kuti në një rrugë. Sa herë ju desh të shkoste në dyqan për t'i marrë të gjitha?	0.00 pikë
4. Ligji për procedurat administrative:	0.00 pikë
5. Organet komunale janë:	0.00 pikë
6. Cila nga këto kompetenca NUK është kompetencë e Presidentit të RKKS:	1.00 pikë
7. Në strukturën "Dërgu është i rëndë", mbiemri "i rëndë" është në shkallën:	0.00 pikë

[Foto. 7] Paraqitja e rezultatit

### Informatë:

-Nëse rezultati ju shfaqet me ngjyre të gjelbër nënkupton që testin me shkrim e keni kaluar me numrin e pikëve të shfaqura në ekran, mirëpo nëse rezultati është me ngjyre të kuqe kjo nënkupton që nuk keni arritur të kaloni testin me shkrim në baze të kritereve të vendosura nga personat përgjegjës.

-Përmbajtja e pyetjeve të paraqitura në fotot 6 dhe 7 janë vetëm për simulim të një testi dhe asesi përmbajtje reale e testit.

### Vërejtje:

1. Ri-testimi nuk është i mundshëm.
2. Publikimi i rezultateve bëhet përmes faqes zyrtare të Policisë së Kosovës.
3. Nuk lejohet komentimi i rezultatit të testit pasi që sistemi është i njëjtë për të gjithë.
4. Kandidatet mund të japin vërejtjet e tyre për testin në formularin e vërejtjeve ANEKSI 5 të cilin e ofron sekretaria.
5. Kandidatet informohen për fazën tjetër të testimit sipas procedurave.

**SUKSESE!**

